



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government


*Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova -Ministry
of Internal Affairs*

Akademia e Kosovës për Siguri Publike
Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost/Kosovo Academy for Public Safety



RRJETI ALUMNI - AKSP

Plani vjetor i aktiviteteve për vitin 2026



PLANI VJETOR I AKTIVITETEVE TË RRJETIT ALUMNI TË AKSP -së

Në mbështetje të Ligjit Nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, bazuar në Vendimin për themelimin e Rrjetit ALUMNI të AKSP-së, datë 12.09.2025, si dhe në përputhje me Rregulloren (AKSP) Nr. 02/2025 për organizimin dhe funksionimin e Rrjetit ALUMNI dhe me standardet e Agjencisë së Kosovës për Akreditim dhe praktikat evropiane për përfshirjen e ALUMNI në sigurimin e cilësisë, hartohet ky plan si dokument operacional dhe strategjik, i cili përcakton drejtimit zhvillimore për vitin 2026.

Rrjeti Alumni përfaqëson një mekanizëm institucional për ruajtjen dhe zhvillimin e lidhjes ndërmjet AKSP-së dhe të diplomuarve të saj. Përfshirja e Alumni-ve konsiderohet element kyç në sigurimin e cilësisë akademike dhe në përmbushjen e standardeve të akreditimit. Përmes këtij rrjeti sigurohet komunikim i strukturuar, shkëmbim përvojash dhe kontribut profesional në zhvillimin institucional. Në këtë kontekst, viti 2026 paraqet fazën e konsolidimit të plotë operacional dhe institucional të këtij mekanizmi përderisa viti 2027 do të paraqet fazën e më tutjeshme zhvillimore të Rrjetit ALUMNI respektivisht të anëtarëve të saj.

QËLLIMI I PLANIT

Qëllimi i këtij plani është të orientojë dhe të koordinojë veprimtaritë e Rrjetit ALUMNI gjatë vitit 2026, duke siguruar funksionalizim të qëndrueshëm dhe kontribut të drejtpërdrejtë në zhvillimin akademik, profesional dhe institucional të AKSP-së. Po ashtu, plani synon të krijojë një dokumentacion të plotë që do të shërbejë për proceset e ardhshme të akreditimit dhe auditimit institucional.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKË 2026

- Konsolidimi organizativ dhe institucional i Rrjetit ALUMNI:** Ky objektiv synon të formalizojë strukturat e Rrjetit, të vendosë procese të qarta vendimmarrëse dhe të sigurojë mbajtjen e takimeve periodike, duke garantuar që funksionimi institucional të jetë i qëndrueshëm dhe i koordinuar.
- Funksionalizimi dhe aktivizimi i Rrjetit ALUMNI:** Ky objektiv synon krijimin, funksionalizimin dhe shfrytëzimin e një sistemi të integruar për

menaxhimin dhe angazhimin e Alumni-ve, përmes ndërtimit të një regjistri zyrtar të strukturuar sipas standardeve të mbrojtjes së të dhënave personale dhe klasifikimit aktiv/pasiv, duke mundësuar akses (çasje) të saktë dhe të shpejtë në informacionin institucional.

Në të njëjtën kohë, objektivi përfshin aktivizimin profesional të Alumni-ve në zhvillimin akademik dhe institucional të AKSP-së, përmes përfshirjes së tyre në forume tematike, tryeza konsultative dhe kontribut konkret në përmirësimin e programeve studimore, duke vlerësuar dhe strukturuar eksperiencën dhe njohuritë e tyre.

Në kuadër të zbatimit për vitin 2026, fokusi do të vendoset fillimisht tek studentët aktualë, përmes organizimit të sesioneve të strukturuar të **mentorimit**, ofrimit të mbështetjes profesionale dhe dokumentimit të rezultateve të arritura. Kjo qasje synon krijimin e një modeli funksional dhe të qëndrueshëm, i cili më pas do të zgjerohet dhe aplikohet edhe për studentët e rinj.

3. **Fuqizimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ngritja e imazhit institucional:** Ky objektivi synon rritjen e dukshmërisë dhe reputacionit institucional të AKSP-së, duke forcuar prezencën e saj përmes publikimeve, materialeve informuese dhe platformave digjitale, si dhe duke siguruar që aktivitetet e Alumni-ve të jenë të dukshme dhe të kontribuojnë drejtpërdrejt në promovimin e vlerave institucionale.

Njëkohësisht, objektivi përfshin zhvillimin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar me institucione homologe, përmes organizimit të vizitave studimore dhe shkëmbimit të praktikave më të mira. Ky bashkëpunim synon të pasurojë përvojën e Alumni-ve, të sjellë njohuri dhe modele të reja në zhvillimin institucional, si dhe të forcojë pozicionimin e AKSP-së në nivel ndërkombëtar.

4. **Monitorimi dhe raportimi i rezultateve:** Objektivi synon të vendosë një mekanizëm të qartë të monitorimit, i bazuar në indikatorë të matshëm, dhe raportim periodik para Menaxhmentit të AKSP-së, duke siguruar transparencë, vlerësim dhe përmirësim të vazhdueshëm të performancës së Rrjetit ALUMNI.

AKTIVITETET E RRJETIT ALUMNI TË AKSP-së PËR VITIN 2026

PERIUDHA	OBJEKTIVI	AKTIVITETI KRYESOR	PËRGJEGJËSI/ MBËSHTETËSI	REZULTATI	IKP / KPI (Key Perf. Ind.)
Mars - Prill 2026	Konsolidimi organizativ dhe institucional i Rrjetit ALUMNI	Takimi i Bordit Alumni; Miratimi i planit; Përcaktimi i kalendarit.	Bordi i Alumni; Kordinatori.	Plan i miratuar	1 takim + plani (dokumenti)
Në vazhdimësi gjatë 2026	Funksionalizimi dhe aktivizimi i Rrjetit ALUMNI	Hartimi i formularit; Regjistrimi & Verifikimi i të dhënave; Aktivizimi profesional (takime, konsultenca, Mentorim, etj)	Bordi i Alumni; Kordinatori.	Senzibilizimi mbi Rrjetin Alumni; Regjistër funksional;	≥50 anëtarë
Gusht - Dhjetor 2026	Fuqizimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ngritja e imazhit institucional	Materiale promovuese (fizike apo digjitale); Platforma online (digjitale); Vizitë studimore dhe aktivitete të ndryshme ndërkombëtare (forume, tryeza, takime, etj).	Bordi i Alumni, FSP DMJ	Materialet e publikuara përmes rrjeteve sociale dhe platformës digjitale; Aktivitete të organizuara dhe të zhvilluara.	2 aktivitete brenda një viti
Nëntor – Dhjetor 2026	Monitorimi dhe raportimi i rezultateve	Analizë vjetore; Raport final; Prezantim	Bordi i Alumni	Raport i miratuar	1 raport

*Plani Vjetor i Punës së Rrjetit ALUMNI të AKSP-së u miratua në takimin e datës 17.06.2026